



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1125/ 5 prot

Datë 14.06.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 555/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16947-01-07-2022, me objekt: **Loti 3** “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, me fond limit 90,323,370 (nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH), ose 745,303.8 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e tre pike tetë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK  
Adresa Blv “Gjergj Fishta”, Kulla 2, Kati 2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Adresa: Blv ”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.01.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16947-01-07-2022, me objekt: **Loti 3** “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, me fond limit 90,323,370 (nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH), ose 745,303.8 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e tre pike tetë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 09.02.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 01.03.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

- “Alar Food & Servis” SHPK	pa ofertë	I skualifikuar
- “Nika” SHPK	71,231,310	I kualifikuar
- “Dion-AL” SHPK	71,913,870	I kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 04.03.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 11.03.2022 operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.531/2 prot datë 11.03.2022 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Dion - AL” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Nika” SHPK.

II.7. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 531/3 prot., datë 24.03.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Dion - AL” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 487 prot, datë 24.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 531/4 prot datë 25.03.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesi “Nika” SHPK, konstatoi se ky ofertues për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur dokumentacionin me emërtim “FORMULAR DEKLARIM LICENCE ABP LOTI 3 FNSH TIRANE”. Me anë të këtij dokumenti, ky ofertues deklaroi: Disponojmë stabiliment të ushtrimit të aktivitetit me Licencë të kategorisë “II.1.A.1- Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me informacion si më poshtë. Vendndodhja: Qarku: Shkodër Rrethi: Shkodër Shkodër B/K: Q/F: Adresa: Zona Industriale, Rruga Lëvizja e Postribës, nr. 31, pranë ish-Drejtorisë së Shërbimeve të transportit Rrugor,*

Godina 2 katëshe, zona kadastrale nr. 8592, nr. pasurie 10/111. Statusi: Pronësi. Nr. i Regjistrimit të posaçëm: LN-3194-04-20 11. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se ky ofertues si pjesë të dokumentacionit të ofertës së tij ka dorëzuar edhe “Kontratë Shërbimi”, e lidhur me datë 05.06.2020, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Special për Kufirin dhe Migracionin “Delta” Radhimë - Vlorë”, me palë Repartin Special për Kufirin dhe Migracionin “Delta” Radhimë - Vlorë dhe shoqërinë “Nika” SHPK. Në pikën 4.1, të nenit 4 të kësaj kontrate është përcaktuar: “Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe përfundon me datë 31.12.2022”, dhe në pikën 7.2 dhe 7.3, neni 7 të saj përcakton: “7.2 Ambientet e gatimit të ushqimit (kuzhina), që do ti jepen sipërmarrësit, do ti nënshtrohen një kontrate qiraje sipas tarifave të përcaktuara në VKM-Nr. 54, datë 05.02.2014, për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera te pasurisë shtetërore”, të ndryshuar. 7.3. Ushqimi do të gatuhet dhe shpërndahet në ambientet e Repartit Special për Kufirin dhe Migracionin ”DELTA ”. Duke filluar nga dita e lidhjes së kontratës e në vijim gatimi dhe shpërndarja të bëhet në ambientet e Repartit Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA. ”

Gjithashtu, ky ofertues ka ngarkuar në SPE, ka dorëzuar edhe “Kontratë Shërbimi”, me nr. 5514, datë 22.09.2021, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër.” E lidhur midis Repartit Ushtarak Nr. 1010, Vau i Dejës, dhe shoqërisë “NIKA” SHPK. Në pikën 3.1, të nenit 3 të kësaj kontrate është përcaktuar: “Kjo kontratë hyn në fuqi me përfundimin e kontratës nr. 3868, datë 30.06.2021 dhe do të jetë në fuqi deri më 31.01.2022”. dhe në pikën 4.2 të nenit 4, është përcaktuar: “Vendi i gatimit do të jetë ambienti i përcaktuar për këtë qëllim brenda midis reparteve të FA-së dhe kontraktuesit në cilësinë e qiramarrësve ose në ambientet që disponon vetë kontraktuesi.”.

Spektori i Monitorimit të Kontratave në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara i ngritur me Urdhër nr.337/1 datë 25.02.2022, “Për monitorimin e zbatimit të kontratës”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (ABP), për monitorimin dhe zbatimin e kontratës, të lidhur për marrëveshjen kuadër me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010” Vau i Dejës, Shkodër” ka kryer monitorimin fizik në ambientet e Repartit Ushtarak Nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër, në datë 03.03.2022. Në Projekt — Raport Monitorimi, nr. 337/8 prot., datë 15.03.2022, rezulton se grupi i monitorimit, ndër të tjera ka konstatuar se: “Operatori Ekonomik “NIKA” ShPK nuk ka vendosur në dispozicion Lejen e Stabilimentit për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, e cila regjistrohet në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit sipas nenit 19 të ligjit nr.9863 dt. 28.01.2008 “Për Ushqimin”. Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “Nika” SHPK ushtron aktivitetin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit brenda ambienteve të Repartit Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA” si dhe Repartit Ushtarak Nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër. Këto dy stabilimente nuk janë pasqyruar nga ofertuesi në deklaratën e tij lidhur me disponimin e stabilimenteve dhe regjistrimin e tyre. Referuar legjislacionit të sipërcituar, çdo mjedis në të cilin zhvillohen veprimtaritë për prodhimin, përpunimin

*apo shpërndarjen e ushqimit kanë detyrimin të regjistrohet, në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*

*Organi qendror blerës gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues të përgatisë dhe të dorëzojë ofertat në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

*Në fazën e vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*

*Në rastin konkret dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” SHPK, në përmbushje të kriterit të përcaktuara në shënimin 1.1 të pikës 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentet e tenderit, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.*

*Në fazën e vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi, vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Bazuar në pikën 2, të nenit 82, të VKM-së 285/2021, ku përcaktohet: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”, ofertuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga organi qendror blerës, në sistemin elektronik të prokurimeve.*

*Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Dion-AL” ShPK qëndron.*

#### *Vendosi*

- 1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AL” ShPK për procedurën e prokurimit, për Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejte” me fond të marrëveshjes kuadër 90,323,370 Lekë (pa TVSH), me numër reference - RF.F-16947-01-07-2022.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

II.9. Me shkresën nr. 531/5 prot., datë 28.03.2022 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Agjencisë Blerjeve të Përqendruara me kërkesën për informacion për sa më poshtë:

*“ 1. A ka paraqitur argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar “Nika” SHPK ?*

*2. A e keni njoftuar operatorin ekonomik “Nika” SHPK lidhur me vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Dion - AL” SHPK ?*

II.10. Me shkresën nr. 531/1 prot., datë 31.03.2022 protokolluar me tonën nr. 531/6 prot., 04.04.2022 autoriteti kontraktor Agjencia Blerjeve të Përqendruara njofton Komisionin e Prokurimit Publik se:

*Në vijim të shkresës tuaj me nr. 531/5 prot., datë 28.03.2022, (protokolluar me tonën nr. 531 prot., datë 30.03.2022) me lëndë: “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije si vijon:*

*Organi Qendror Blerës, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin përkatësisht si vijon:*

*- Për Lotin I me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi” për Spitalin Universitar të Traumës, Organi Qendror Blerës me shkresën nr. 486 prot., date 24.03.2022, me lëndë: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt. Loti 1- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi” për Spitalin Universitar të Traumës” si dhe me email-it datë 24.03.2022, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin për këtë procedurë prokurimi.*

*- Për Lotin 3 me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, Organi Qendror Blerës, me shkresën nr. 487 prot., date 24.03.2022, me lëndë: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt, - Loti 3- “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, si dhe me email-it datë 24.03.2022, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin për këtë procedurë prokurimi.*

*Gjithashtu ju bëjmë me dije se Vendimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në Organin Qendror Blerës, u janë njoftuar Operatorëve Ekonomikë përkatës, me shkresë zyrtare si dhe në mënyre elektronike (email) në datën 24.03.2022.*

*Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje me Lotin 3 me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, i është dërguar edhe operatorit ekonomik “Nika” SHPK, me shkresë zyrtare si dhe në mënyre elektronike (email) në datën 25.03.2022.*

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “Nika” SHPK **nuk ka** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.12. Në datën 05.04.2022 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 316/2022 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16947-01-07-2022, me objekt: **Loti 3** “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë”, me fond limit 90,323,370 (nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë)

*Lekë (pa TVSH), ose 745,303.8 (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e tre pike tetë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.*

2. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
3. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dion-AL” SHPK.*

4. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.13. Referuar sistemit prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 19.04.2022 autoriteti kontraktor rivlerësoi procedurën e prokurimit objekt-ankimi duke njoftuar elektronikisht edhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si më poshtë:

- “Alar Food & Servis” SHPK	pa ofertë	I skualifikuar
- “Nika” SHPK	71,231,310	I skualifikuar
- “Dion-AL” SHPK	71,913,870	I kualifikuar

II.14. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 21.04.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.15. Referuar materialeve të fashikullit administrativ nr. 1125 prot, datë 24.05.2022, si dhe verifikimeve të Sistemit të Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 17.05.2022 ka njoftuar operatorin ekonomik “Dion – AL” SHPK në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura prokurimit objekt – ankimi me argumentin si më poshtë vijon:

*Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomike” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacionin e kerkuar për cdo stabiliment (ne pronesi dhe /ose qira). Pas verifikimit të dokumentacionit të ofertuesit “DION-AL SHPK“, rezulton se ky i fundit nuk ka deklaruar dhe nuk ka paraqitur licencën perkatese për stabilimentin ne Repartin Ushtarak 1060 (Forcat Tokesore Babrru, Tirane) ne te cilin ushtron sherbimin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, sipas kontrates nr. 2929 date 17.05.2021, te reflektuar ne vertetimin nr. 674/1 date 08.02.2022 te leshuar nga Komanda Mbeshtetese. Bazuar në Kriteret e Kualifikimit të parashikuara në DST, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

II.16. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 19.05.2022 ka publikuar Njoftim-Anulimin për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.17. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 24.05.2022 operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.18. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1125/2 prot datë 26.05.2022 me arsyet skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Dion - AL” SHPK.

II.19. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1125/3 prot., datë 03.06.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Dion - AL” SHPK.

II.20. Me shkresën nr. 924 prot, datë 06.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1125/4 prot datë 08.06.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin nr. 842/2 prot, datë 03.06.2022 ka arsyetuar si më poshtë:

[...]

*Nga informacioni i dhënë në deklaratën e mësipërme rezulton se stabilimenti me adresë “Reparti Ushtarak Nr. 1060, Babrru Tiranë”, për të cilin është bërë skualifikimi i OE “Dion – AL” SHPK, nuk është deklaruar nga ky operator si stabiliment me status në pronësi apo me qira.*

*Nga verifikimi i dokumenteve bashkëngjitur ankesës së paraqitur nga ky operator rezulton se në datë 14.01.2022, me anë të shkresës nr. 10 prot., lënda “Kërkesë për marrje me qira të ambientit” drejtuar Repartit Ushtarak Nr. 1060 , Babrru, Tiranë, OE “Dion –AL” SHPK kërkon miratimin për marrje me qira të kuzhinës me sipërfaqe 114m2, e cila ndodhet brenda*



*Repartit Ushtarak nr. 1060, Babrru Tiranë. Ky ambient kërkohet të përdoret si kuzhinë për nevojat e realizimit të kontratës.*

*Në datën 14.01.2022. me anë të shkresës nr. 11 prot, me lëndë “Dërgim oferte”, OE Dion – AL ShPK ka dërguar ofertën për marrje me qira pranë këtij reparti në vlerën 150 lekë/m2.*

*Në datën 23.03.2022 është lidhur kontrata “Kontratë për dhënie me qira të ambientit kuzhinë” me nr. 336/1 prot, me palë Komanda e Forcës Tokësore dhe shoqërisë “Dion-AL” SHPK, me objekt “...dhënie me qira e pasurisë shtetërore: objekti “Kuzhinë” me sipërfaqe 114 m2 në përgjegjësi administrimi të Repartit Ushtarak nr. 1060, Babrru, Tiranë, për përdorim nga shoqëria “Dion – AL” SHPK për vënien në funksion aktivitetit për trajtimin me ushqim të efektivave të repartit.*

*Dokumentacioni i sipërcituar është konfirmuar edhe nga Reparti Ushtarak nr. 1060, në rrugë elektronike, (Bashkëlidhur e-maili)*

*Nga verifikimi i dokumentit bashkëlidhur ankesës “Licence” me nr. LN-3980-04-2022, si dhe verifikimit të tij në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se në datë 04.04.2022 është miratuar kërkesa për LICENCËN me Kodin II.1.A (1), dhe në 21.04.2022 është lëshuar Licenca me Kodin II.1.A, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Shërbime gatimi dhe shpërndarje ushqimi. (catering)”*

*Theksojmë se procedura e prokurimit objekt ankimi ka pas si datë përfundimtare për dorëzimin e ofertave për operatorët ekonomik të interesuar datën 09.02.2022.*

*Për sa më sipër, referuar dokumentacionit shoqërues, konstatohet se deri në datën 09.02.2022, ofertuesi nuk e ka disponuar ambientin në Repartin Ushtarak nr. 1060, edhe pas kërkesës së tij të datës 14.01.2022, pasi kontrata e qerasë për këtë ambient është lidhur më vonë, konkretisht në datën 23.03.2022.*

*Në kuptim të legjislacionit të sipërcituar si dhe referuar dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, operatori ekonomik “Dion AL” ShPK në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë”, nuk e ka disponuar ambientin me adresë “Reparti Ushtarak nr. 1060, Babrru, Tiranë”, e si rrjedhim nuk mund ta deklaronte si pjesë e stabilimenteve në disponim (pronësi/qira), si rrjedhim dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Dion – AL” ShPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shënimin 1.1 të pikës 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentet standarde të tenderit, konsiderohet i vlefshëm.*

*Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Dion-AL” ShPK qëndron.*

*Vendosi*

1. *Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AL” ShPK për procedurën e prokurimit, për Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejte” me fond të marrëveshjes kuadër 90,323,370 Lekë (pa TVSH), me numër reference - RF.F-16947-01-07-2022.*
2. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
3. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dion-AL” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 924 prot, datë 06.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1125/4 prot datë 08.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin nr. 842/2 prot, datë 03.06.2022 ka arsyetuar si më poshtë:

[...]

*Nga informacioni i dhënë në deklaratën e mësipërme rezulton se stabilimenti me adresë “Reparti Ushtarak Nr. 1060, Babrru Tiranë”, për të cilin është bërë skualifikimi i OE “Dion – AL” SHPK, nuk është deklaruar nga ky operator si stabiliment me status në pronësi apo me qira.*

*Nga verifikimi i dokumenteve bashkëngjitur ankesës së paraqitur nga ky operator rezulton se në datë 14.01.2022, me anë të shkresës nr. 10 prot., lënda “Kërkesë për marrje me qira të ambientit” drejtuar Repartit Ushtarak Nr. 1060, Babrru, Tiranë, OE “Dion –AL” SHPK kërkon miratimin për marrje me qira të kuzhinës me sipërfaqe 114m<sup>2</sup>, e cila ndodhet brenda Repartit Ushtarak nr. 1060, Babrru Tiranë. Ky ambient kërkohet të përdoret si kuzhinë për nevojat e realizimit të kontratës.*

*Në datën 14.01.2022. me anë të shkresës nr. 11 prot, me lëndë “Dërgim oferte”, OE Dion – AL ShPK ka dërguar ofertën për marrje me qira pranë këtij reparti në vlerën 150 lekë/m<sup>2</sup>.*

Në datën 23.03.2022 është lidhur kontrata “Kontratë për dhënie me qira të ambientit kuzhinë” me nr. 336/1 prot, me palë Komanda e Forcës Tokësore dhe shoqërisë “Dion-AL” SHPK, me objekt “...dhënie me qira e pasurisë shtetërore: objekti “Kuzhinë” me sipërfaqe 114 m2 në përgjegjësi administrimi të Repartit Ushtarak nr. 1060, Babrru, Tiranë, për përdorim nga shoqëria “Dion – AL” SHPK për vënien në funksion aktivitetit për trajtimin me ushqim të efektivave të repartit.

Dokumentacioni i sipërcituar është konfirmuar edhe nga Reparti Ushtarak nr. 1060, në rrugë elektronike, (Bashkëlidhur e-maili)

Nga verifikimi i dokumentit bashkëlidhur ankesës “Licence” me nr. LN-3980-04-2022, si dhe verifikimit të tij në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se në datë 04.04.2022 është miratuar kërkesa për LICENCËN me Kodin II.1.A (1), dhe në 21.04.2022 është lëshuar Licenca me Kodin II.1.A, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë “Shërbime gatimi dhe shpërndarje ushqimi. (catering)”

Theksojmë se procedura e prokurimit objekt-ankimi ka pasur si datë përfundimtare për dorëzimin e ofertave për operatorët ekonomik të interesuar datën 09.02.2022.

Për sa më sipër, referuar dokumentacionit shoqërues, konstatohet se deri në datën 09.02.2022, ofertuesi nuk e ka disponuar ambientin në Repartin Ushtarak nr. 1060, edhe pas kërkesës së tij të datës 14.01.2022, pasi kontrata e qerasë për këtë ambient është lidhur më vonë, konkretisht në datën 23.03.2022.

Në kuptim të legjislacionit të sipërcituar si dhe referuar dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, operatori ekonomik “Dion AL” ShPK në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë”, nuk e ka disponuar ambientin me adresë “Reparti Ushtarak nr. 1060, Babrru, Tiranë”, e si rrjedhim nuk mund ta deklaronte si pjesë e stabilimenteve në disponim (pronësi/qira), si rrjedhim dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Dion – AL” ShPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shënimin 1.1 të pikës 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentet standarde të tenderit, konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Dion-AL” ShPK qëndron.

#### Vendosi

1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AL” ShPK për procedurën e prokurimit, për Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejte” me fond të marrëveshjes kuadër 90,323,370 Lekë (pa TVSH), me numër reference - RF.F-16947-01-07-2022.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 *“Për prokurimin Publik”* i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

i. *për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. *e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

c) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

3. *Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

a) *nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

b) *nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 3 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

5. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Dion-AL*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-16947-01-07-2022*, me objekt: **Loti 3** “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për *Repartin e Ndërhyrjes së shpejtë, Tiranë*”, me fond limit *90,323,370* (nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH), ose *745,303.8* (shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e tre pike tetë) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
6. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Dion-AL*” SHPK.
8. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**